



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Uprava za Urbanizam, Planiranje i Zastitu Okoline
Department for Urbanism, Planning and Environmental Protection

Duke u bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor nr. 04/L-174, neni 20, paragrafët 1.1–1.5, si dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor dhe pjesëmarrjen e publikut, duke u bazuar edhe në vendimin e Kuvendit Komunal të Rahovecit nr. 01-22/999, të datës 16.12.2022, Komuna e Rahovecit, shpall:

NJOFTIM

Për hapjen e shqyrtimit publik të draftit të Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034

Ftesë për pjesëmarrje në shqyrtim publik të draftit të Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034 për: qytetarët e Komunës së Rahovecit, organizatat, shoqatat, grupet e interesit dhe të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në shqyrtimin publik të draftit të Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034.

Lokacioni: Salla e Kuvendit Komunal, Rahovec

Data: 16.7.2026

Koha: 10:00

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka kënaqësinë t'ju ftojë të jeni pjesë e shqyrtimit publik të draftit të Hartës Zonale të Komunës së Rahovecit 2026–2034. Pjesëmarrja dhe kontributi juaj janë të rëndësishëm për procesin e planifikimit dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të komunës. Përmes këtij njoftimi publik ftohen qytetarët që të zhvillojnë shqyrtime publike në mënyrë që të inkurajojnë pjesëmarrjen transparente të publikut në këtë dokument të planifikimit hapësinor. Vendimi për shpalljen e shqyrtimit publik të draftit të Hartës Zonale Komunale është miratuar me vendimin nr.01/148, të datës 29.05.2026.

Shqyrtimi publik do të zgjasë 30 ditë nga dita e hapjes, përkatësisht: 16.7.2026 - 16.8.2026.

Vegëzën elektronike për qasje në versionin digjital të dokumentit të HZK-së mund ta gjeni në:

<https://rahovec.rks-gov.net/draft-harta-zonale/>

Vërejtjet, komentet dhe sugjerimet mund të bëhen në librin e vërejtjeve apo përmes adresës elektronike: albnor.mullabazi@rks-gov.net, shpejtimmustafa@rks-gov.net dhe diellza.canta@rks-gov.net

Shqyrtimi publik do të jetë i hapur çdo ditë pune, nga ora 10:00 deri në 14:00, në objektin e Kuvendit Komunal në Rahovec.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në përfundimin e procedurave për aprovimin e HZK-së Rahovec 2026 – 2034.

Datë: 7.7.2026

Albnor Mullabazi

Drejtor për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit

Komuna e Rahovecit

